

Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 988/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) paraqitur kundër komisionarit të subjektit politik AAK-LDD, për shkak të asistimit për të votuar, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 01.12.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), në të cilën pretendohet se në qendrën e votimit 2403a në fshatin Mushtisht të Suharekës, komisionari i subjektit politik AAK-LDD, Maliq Shala ka asistuar 7 (shtatë) persona për të votuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*


Pretendimet ankimore të palës ankuese, se në qendrën e votimit 2403a, në fshatin Mushtisht të Suharekës, Maliq Shala komisionar i subjektit politik AAK-LDD ka asistuar 7(shtatë) persona për të votuar, PZAP-i konstaton se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk është ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljen e supozuar. PZAP-i, vlerëson

se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenit 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 988/2013 më datën 04.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala





Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.